



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 20.11.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “ PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9942, DATË
26.06.2008, “PËR PARANDALIMIN E ÇRREGULLIMEVE TË SHKAKTUARA NGA
PAMJAFTUESHMËRIA E JODIT NË ORGANIZMIN E NJERIUT”, TË NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” të ndryshuar”, në mbledhjet e datave 16, 29 dhe 30 tetor, 6 dhe 20 nëntor 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Besnik Baraj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësues të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Institutit të Shëndetit Publik.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” të ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projekt ligji synon përmirësimin e ligjit . 9942, datë 26.06.2008 dhe forcimin e zbatimit të tij, me qëllim rritjen dhe përmirësimin e standardeve për konsumimin e kripës së jodizuar në popullatën shqiptare.

Ndryshimet e propozuara kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës, analizat laboratorike për përcaktimin e nivelit të jodit në mostrën e kripës së jodizuar, në mënyrë që të ato të bëhen sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-it dhe UNICEF-it, si dhe përcaktimin e institucioneve që do të kryejnë monitorimin dhe inspektimin e kontrollit të kripës së jodizuar.

Objektivat kryesore të këtij projektligji janë:

- Garantimi i kryerjes së kontrollit të kripës ushqimore të prodhuar nga stabilimentet e jodizimit të kripës ushqimore në Republikën e Shqipërisë;
- Garantimi i kryerjes së kontrollit të kripës ushqimore të importuar në Republikën e Shqipërisë, përmes marrjes në kohë të mostrës dhe analizës laboratorike për nivelin e jodit, në çastin e futjes së kripës në pikat doganore në RSH.;
- Garantimi i kryerjes së monitorimit të mbulimit të territorit të vendit, të nivelit të përmbajtjes së jodit në kripën ushqimore,

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 9 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Projektligji “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” të ndryshuar,” nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

- ***Konsultimi publik***

Referuar relacionit që shoqëron projektligjin, rezulton se në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ky projektligj i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik (RENJK),

Në respektim të parimit të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes, mbi të cilat zhvillohet veprimtaria parlamentare, si dhe bazuar në përcaktimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni zhvilloi

një séance dëgjimore me përfaqësues të Shoqatës së Industrialistëve Shqiptarë dhe subjekte të industrisë së përpunimit të produkteve ushqimore.

Përfaqësuesi i Shoqatës së Industrialistëve, Z. Alban Zusi, vlerësoi nismën e ndërmarrë nga qeveria për rritjen e kontrollit të përdorimit të kripës së jodizuar, por shprehu shqetësimet lidhur me problematikat që lindin në rastin kur kripa përdoret në industrinë ushqimore dhe përpunuese, në cilësinë e konservantit. Në momentin që kripa kryen rolin e konservantit, detyrimi ligjor për ta jodizuar atë, rrit koston e jonizimit me 10%-15% për sasi, kështu , kostoja e kripës automatikisht shkon në koston e produktit final. Kështu, në industrinë ushqimore impakti është disa qindra mijë euro në vit, të cilat e bëjnë industrinë tonë më pak konkurruese, krahasuar me konkurrentët tanë rajonalë, që nuk e kanë këtë lloj detyrimi.

Gjithashtu, Z. Zusi parashtroi edhe vështirësitë procedurale me të cilat ndeshet biznesi, në pikat doganore, në rastin e eksportimit të kripës së pajodizuar. Në këto raste, operatori duhet të pajiset me një autorizim të posaçëm, pra të vërtetojë që kripa do të përdoret për funksione të tjera. Shtimi i hallkave të tjera procedurale përbën, gjithashtu, kosto të shtuara për biznesin.

Në këto kushte, propozohet një ndryshim në projektligj për të lejuar importimin e kripës së pajodizuar, për t'u ripunuar për qëllime industriale dhe jo për t'u tregtuar.

• *Diskutimi në komision*

Projektligji është diskutuar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në mbledhjet e datave 16, 29 dhe 30 tetor, 6 dhe 20 nëntor 2019.

Në mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe përfaqësues të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Gjatë shqyrtimit në Komision, relatori vlerësoi nismën e propozuar nga qeveria, duke theksuar ndikimin dhe përfitimet që ka përdorimi i jodit në organizmin e njeriut. Mungesa e sasisë së nevojshme të jodit, ose mos-marrja e tij në nivelet e duhura/të rekomanduara shoqërohet me pasoja të rënda për shëndetin e njeriut që ndikojnë në zhvillimin intelektual dhe fizik të njeriut si: prapambetje mendore, defekte fizike, strumë, duke sjellë dëmtime të rënda veçanërisht tek gratë shtatzëna dhe fëmijët.

Diskutimet e anëtarëve të Komisionit u fokusuan tek: nevoja e kryerjes së këtyre ndryshimeve; risitë që propozon projektligji; institucionet që do të kryejnë kontrollin dhe monitorimin e kripës së jonizuar, impaktin që do të ketë tek operatorët e biznesit vendas, që prodhojnë, importojnë apo eksportojnë kripë për përdorim ushqimor etj.

Lidhur me nevojën e kryerjes së ndryshimeve në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” të ndryshuar”,

përfaqësuesit e ministrisë u shprehën se pas ndryshimeve ligjore të vitit 2013, të cilat prekën rolet e institucioneve aktuale në fushën e përgjegjësisë së ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u identifikuan mangësi në legjislacion, pasi mbetën të papërcaktuar mekanizmat institucionalë kontrollues dhe monitorues të kripës ushqimore. Këto mungesa në legjislacion u reflektuan dhe si problematika në zbatimin e ligjit, në drejtim të inspektimit dhe monitorimit.

Rrjedhimisht lindi nevoja për disa ndryshime në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008, fokusuar në komponentët e inspektimit dhe monitorimit të kripës së jodizuar dhe rolin e institucioneve të përfshira në to si: përcaktimin e institucioneve që do bëjnë monitorimin dhe inspektimin e kripës, ndarjen e qartë të kompetencave për procesin e monitorimit, dhe dhënien e detyrave të çdo institucioni, duke shmangur mbivendosjet dhe plotësuar boshllëqet që ekzistojnë aktualisht. Për këtë qëllim, është hartuar dhe propozohet për miratim projektligji në shqyrtim. Duke përcaktuar qartë se cilët janë institucionet që do të bëjnë kontrollin e kripës së jonizuar, kontrollin në pikat doganore dhe monitorimin e jodit në kripë, kompetencat dhe detyrat e tyre, do të mundësohet një kontroll 100% i nivelit të jodit në kripë. Gjithashtu, në projektligj është shtuar edhe një nen mbi kërkesat për gjurmueshmërinë e kripës për përdorim njerëzor, shtazor dhe në industrinë ushqimore.

Një shqetësim tjetër i deputetëve ishte edhe ai lidhur me mënyrën e trajtimit në projektligj, të kontrollit dhe monitorimit të kripës së prodhuar në vend. Projektligji vendos detyrimin për kontrollin dhe monitorimin e nivelit të jodit në kripë, nëpërmjet kryerjes së analizave që në pikën doganore, tarifa e së cilës paguhet nga operatori ekonomik, ndërkohë që nuk detyron të njëjtin rregullim për kripën e prodhuar në vend, duke krijuar regjime të ndryshme trajtimit për të njëjtin produkt, ndërkohë që pjesa më e madhe e kripës, rreth 85%, në treg gjatë viteve të fundit sigurohet nga prodhuesit vendas të kripës së jodizuar në krahasim me importet .

Bazuar në nenin 37 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni zhvilloi një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në të cilën u diskutua mbi nevojën e përmirësimeve në projektligj, si dhe u prezantuan propozimet konkrete për ndryshime.

Z. Baraj, në cilësinë e relatorit, në mbështetje të shqetësimeve të operatorëve të biznesit, propozoi ndryshimin e nenit 12/1, për të hequr detyrimin e subjekteve importuese të kripës, për të paguar kryerjen e analizës në pikën doganore, në rastin kur ky produkt shoqërohet me dokumentacion analizash të rregullta, duke e lënë në të drejtën e doganës, që në mënyrë frekvente të kryejë kontrolle për çdo lloj produkti.

Gjithashtu, u shqyrtuan edhe propozimet e depozituara nga deputeti, Z. Taulant Balla, i cili propozon një riformulimin të nenit 9, që ka lidhje, së pari, me përjashtimet nga detyrimi për fortifikimin me jod të kripës, pra bëhet fjalë vetëm për rastin e kripës që importohet si lëndë e parë me qëllim fortifikimin, dhe së dyti, për kripën që importohet e pajodizuar, por me destinacion rieksporin, kryesisht nga kompanitë e përpunimit të peshkut apo të ushqimeve që janë një lloj fasonerie apo që punojnë për eksport. Këto kompani nuk janë të detyruara, sipas këtij amendamenti, të përdorin kripë të jodizuar,

sepse tregjet ku eksportohen jo detyrimisht e kanë këtë kërkesë, pasi jo të gjitha vendet kanë deficiencë jodi.

Në amendamentin e zotit Balla ka edhe një propozim tjetër, që në rastet përjashtimore t'u lihet si e drejtë ministrit të Bujqësisë dhe ministrit të Shëndetësisë, që me një udhëzim të përbashkët të listojnë ato lloje ushqimesh që lejohen të tregtohen pa kripë të jodizuar në vend.

Edhe ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural prezantoi disa amendamente për projektligjin, të cilat lidhen me lejimin e përdorimit të kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimeve, përgatitja e të cilave nuk parashikon domosdoshmërisht përdorimin e kripës së jonizuar, si dhe në rastet kur kripa shërben si një ndër inputet e procesit teknologjik, me qëllim konservimin e ndërmjetëm, regjiën, reaksionet kimike të procesit të përpunimit, pra rastet kur produkti është i destinuar për përpunim të mëtejshëm.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, diskutimet e deputetëve u fokusuan në një çështje shumë të diskutuar, atë të ndarjes së qartë të kompetencave të inspektimit ndërmjet inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Për të përcaktuar qartë këtë ndarje u propozua që në projektligj të përcaktohet qartë se strukturat rajonale ose vendore të shëndetësisë dhe inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, do të jenë përgjegjës për kontrollin, monitorimin dhe inspektimin e nivelit të jodit në kripë, ndërkohë që AKU do të jetë përgjegjës për cilësinë e kripës në aspektin ushqimor.

Gjithashtu, deputetët propozuan ndryshime në projektligj për të ristrukturuar nenet që lidhen me kontrollin dhe monitorimin e kripës, me qëllim qartësimin e procedurave, si dhe rishikimin e nenit mbi gjurmueshmërinë, duke zgjeruar informacionin që subjektet duhet të ruajnë për të siguruar gjurmueshmërinë e kripës së jodizuar.

- ***Ndryshime të projektaktit***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi projektligjin, në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni, miratoi vërejtjet si më poshtë:

1. **Neni 3 i projektligjit**, të riformulohet si vijon:

“Neni 3

Në nenin 6, pas paragrafit të parë shtohen paragrafët, si më poshtë vijon:

“Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar, me qëllim fortifikimin e kripës me jod, nga subjekte të licencuara për fortifikimin e kripës, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin.

Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar, me qëllim përdorimin e saj në produktet ushqimore të destinuara për eksport.

Lejohet përdorimi i kripës ushqimore të pajodizuar, kur përdoret si input i procesit teknologjik, me qëllim konservimin e ndërmjetëm, regjiën, reaksionet kimike të procesit të përpunimit, vetëm mbi bazën e kartës teknologjike të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Në këto raste produkti është i destinuar për përpunim të mëtejshëm.

Lejohet eksporti i kripës ushqimore të pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar.”.

2. **Neni 4 i projektligjit**, të riformulohet si vijon:

“Neni 4

Neni 12 riformulohet, si më poshtë vijon:

“Neni 12

Kontrolli i nivelit të jodit në kripë

1. Kontrolli i nivelit të jodit në kripën ushqimore të prodhuar në vend, ose të importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, bëhet nëpërmjet analizave laboratorike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-it dhe UNICEF-it”.
2. Kontrolli i nivelit të jodit në kripë, në subjektet prodhuese të kripës ushqimore të jodizuar, bëhet për çdo parti malli, përpara hedhjes së saj në treg, nga struktura rajonale e shëndetësisë. Për kryerjen e analizave të kripës, struktura rajonale përdor laboratorët e brendshëm të saj.
3. Kripa ushqimore e jodizuar, që importohet në Republikën e Shqipërisë nga subjektet importuese, i nënshtrohet kontrollit për nivelin e jodit, në pikat doganore (degët doganore kufitare). Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor, strukturat rajonale të shëndetësisë. Për kripën e jodizuar të importit, edhe në rastet kur në dokumentet shoqëruese është pasqyruar niveli i jodit, importuesi është i detyruar të kryejë analizën laboratorike në laboratorët e strukturës rajonale të shëndetësisë, për nivelin e jodit në çastin e futjes së kripës në pikën doganore.
4. Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar përballohen nga subjektet prodhuese ose importuese të kripës së jodizuar. Tarifat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Inspektimi për nivelin e jodit në kripë kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin shëndetësor në bazë të: planifikimit; vlerësimit të riskut, raporteve të monitorimit dhe sinjalizimeve nga burime të tjera.”.

3. **Neni 5 i projektligjit**, të riformulohet si vijon:

“Neni 5

Neni 13 riformulohet si vijon:

“Neni 13

Monitorimi i nivelit të jodit në kripë

1. Monitorimi është procesi sistematik i mbledhjes së mostrave të kripës së jodizuar, analizimit dhe përdorimit të informacionit, me qëllim sigurimin e niveleve të jodit në kripën e destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Monitorimi i nivelit të jodit në kripë në pikat e prodhimit në vend, në ato të importimit dhe në pikat e shitjes me pakicë/shumicë kryhet nga strukturat rajonale ose vendore të shëndetësisë, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre.
3. Prodhuesi i kripës së jodizuar në vend dhe importuesi i saj janë përgjegjës për nivelin e jodit në kripë.”.

4. **Neni 6 i projektligjit**, të riformulohet si vijon:

“Neni 6

Pas nenit 13/1 shtohet neni 13/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 13/2

Kërkesat për gjurmueshmërinë e kripës për konsum njerëzor, shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore

1. Operatori i biznesit ushqimor krijon dhe mban informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, jodizimit të kripës dhe shpërndarjes së saj.
2. Informacioni i nevojshëm për gjurmueshmërinë përfshin këto të dhëna:
 - a) Identifikimin e çdo subjekti tregtar/personi juridik apo fizik, nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me kripë;
 - b) Identifikimin e çdo subjekti tregtar, të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizuar me kripë të jodizuar.
 - c) Sasinë e kripës së furnizuar dhe nivelin e jodit në momentin e furnizimit.
 - d) Datën e skadencës së kripës së furnizuar.

3. Operatori i biznesit ushqimor ruan të dhënat e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, për jo më pak se 3 vjet dhe siguron që këto të dhëna t'i jepen menjëherë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë.
4. Kripa ushqimore e nxjerrë në treg, ose që mund të nxirret në treg, duhet të etiketohet e të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë.”.

5. **Neni 7 i projektligjit**, të riformulohet si vijon:

“Neni 7

Në nenin 17, pikat 1 dhe 2 të riformulohen si vijon:

- “1. Importimi, prodhimi, shpërndarja, tregtimi apo marketingu i kripës së pajodizuar ose me nivel jodi më të ulët se ai i përcaktuar në këtë ligj, për konsum njerëzor e shtazor, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.
2. Përdorimi i kripës së pajodizuar ose i kripës së jodizuar, me një nivel më të ulët se ai i përcaktuar në këtë ligj, në industrinë ushqimore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.”.

6. **Neni 8 i projektligjit**, të riformulohet si vijon:

“Neni 8

Në pikën 2, të nenit 21, pas shprehjes “të nenit 11”, shtohet shprehja “dhe të pikës 4, të nenit 12”.

RELATOR

KRYETAR

Besnik BARAJ

Niko PELESHI